

Nevojat e Organizatave të Shoqërisë Civile për Ekspertizë nga Diaspora



Autorët/Hulumtuesit:
Arbnor Mjeku

Rishikuar nga:

Lenhard Hamza
Drenusha Bujari

Publikuar nga: OJQ GERMIN
Tringë Smajli 49/7
10000 Prishtinë, Republic of Kosovo
+383 (0) 49 542 525
info@germin.org
www.germin.org

© 2022. të gjitha të drejtat e rezervuara

Mbështetur nga KCSF/USAID

Përveç citimeve të shkurtra të bëra për qëllim kritike dhe riprodhimi, asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo lloj mënyre, elektronike, përfshirë fotokopjimin, incizimin apo ruajtjen e informacionit e rikthimin e tij me anë të ndonjë sistemi, pa lejen paraprake të autorit.

Shënim:

Opinionet e shprehura në këtë botim janë të GERMIN, dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet zyrtare të USAID/KCSF.

PËRMBAJTJA:

HYRJE	3
EMIGRIMI I PROFESIONISTËVE DHE PROGRAMI “ANGAZHIMI I PROFESIONISTËVE NGA DIASPORA”	4
PROFESIONISTËT NGA DIASPORA DHE GERMIN	6
QËLLIMI	6
METODOLOGJIA	7
MBLEDHJA E TË DHËNAVE	7
PËRPUNIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE	8
ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË	9
NEVOJAT E ORGANIZATAVE PËR PROFESIONISTË NGA DIASPORA	13
KONKLuzion	20
REFERENCAT	21
INTERVISTAT:	21

HYRJJE

Diaspora shqiptare nga Kosova përgjatë dekadave të fundit është zhvilluar shumë në fusha të ndryshme profesionale dhe shkencore. Kjo diasporë, kryesisht e përqendruar në vendet e zhvilluara, është dërguesja më e madhe e remitançave në vend të cilat ndikojnë në stabilitetin ekonomik të vendit tonë. Për më tepër, diaspora shqiptare është e gatshme të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit edhe përmes angazhimit të tyre në vendin amë.

Andaj, GERMIN në raportet e kaluara ka analizuar potencialin e profesionsitëve nga diaspora dhe nevojat e institucioneve publike për ekspertizë nga diaspora. Ndërsa, këtë radhë GERMIN është fokusuar në vlerësimin e nevojave të organizatave të shoqërisë civile për ekspertizë nga diaspora, si dhe sfidat dhe pengesat që ato mund të kenë për qëndrueshmërinë e tyre në aspektin e ngritjes së kapaciteteve humane, e po ashtu edhe atyre financiare.

Ky raport studimor është përpiluar në kuadër të programit “Angazhimi Profesionistëve nga Diaspora” që mundësohet nga GERMIN në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar i cili implementohet nga KCSF në partneritet me USAID Kosova. Qëllimi i studimit është të shpalosë të dhënat cilësore dhe sasiore të cilat janë mbledhur përmes intervistave dhe anketimit elektronik me organizata të shoqërisë civile. Përmes këtij raporti ofrohet ndihmë në kuptimin dhe analizimin e nevojave të organizatave të shoqërisë civile për ekspertizë dhe profilet që iu mungojnë në mënyrë që të krijohet bashkëpunim me diasporën përmes programit “Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora”. Prandaj, ky raport u dedikohet për përdorim ekspertëve nga diaspora, organizatave donatore dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC).

Emigrimi i profesionistëve dhe programi “Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora”

Lëvizjet e shqiptarëve nga Kosova nga një vend në vendin tjetër zënë fillesat e tyre shumë herët në rrjedha të ndryshme kohore dhe shkakore. Gjatë shekullit XX, emigrimi drejt vendeve të zhvilluara ka ndodhur si pasojë, ndër të tjera, e represionit të shtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë, pamundësisë së qasjes në punë dhe pabarazisë shoqërore. Ndryshe nga shekulli i kaluar, në kohën aktuale gjendja është ndryshe duke marrë parasysh pavarësinë e vendit dhe tranzicionin që vendi po kalon. Mirëpo përkundër këtyre, emigrimi, tashmë me arsye dhe mënyra të ndryshme nga e kaluara, veçse është duke u rritur me hapa të shpejtë. Në të kaluarën emigrimi ishte kryesisht ilegal dhe pa asnjë mundësi ligjore për të lehtësuar lëvizjen dhe punësimin. Ndërsa, tani emigrimi ndodh në mënyrë legale dhe me kërkesa e oferta për punësim kryesisht nga vendet e zhvilluara, të cilat ofrojnë sisteme të ndryshme alternative jetësore dhe sociale. Tërë këto ndikojnë në vendimet e profesionistëve për t’u larguar nga Kosova.

Emigrimi i profesionistëve nga Kosova drejt vendeve të zhvilluara vazhdon të ketë rrjedhën dhe ndikimin e saj në shumë sfera, të tilla si largimi i forcës punëtore të kualifikuar, mungesa e profileve në vendet apo pozitat e ndjeshme dhe të rëndësishme që lidhen direkt me zhvillimin apo stabilitetin e vendit, si dhe zhvillimin e projekteve. Për më tepër, diaspora ka qenë pjesë e shumë politikave dhe proceseve nëpër të cilat ka kaluar Kosova, si dhe zë një pozitë kyçe në stabilizimin ekonomik të Kosovës. Prandaj, është shumë e rëndësishme që qasja ndaj tyre të ndryshojë dhe t’i shikojmë si mundësi zhvillimi jo vetëm në aspekt ekonomik, mirëpo edhe në atë social, duke shfrytëzuar ekspertizat e tyre të fituara në vendet e zhvilluara në organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, gjithmonë duke u bazuar në nevojat e tyre për ekspertizë, pra në fushat se ku e shohin më të nevojshme angazhimin e tyre.

Profilet e profesionistëve të larguar, veçse të njohura, ndikojnë negativisht në institucionet dhe organizatat në vend, të cilët kanë shprehur nevojat e tyre për profile që do të ndihmonin në stabilitetin apo qëndrueshmërinë e tyre. Një gjë e tillë është parë gjatë takimit të mbajtur të organizatës GERMIN me organizatat e tjera të shoqërisë civile ku u lansua projekti “Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora”. Në këtë takim OShC-të patën mundësinë të shfaqin nevojat e tyre

në lidhje me profilet të cilat mendojnë se do të i ndihmonin në qëndrueshmërinë dhe profesionalitetin e organizatës.¹

Programi për Angazhimin e Profesionistëve nga Diaspora (EDP) është program i cili ka për qëllim të sjellë ekspertë nga diaspora në vendet amë për të kontribuar në zhvillimin e tyre me ekspertizën dhe përvojat e tyre nga vendet e zhvilluara. Baza e të dhënave e GERMIN përkon me më shumë se 30 mijë profesionistë në të gjithë botën. Prandaj, bazuar në këtë pasuri të informacionit dhe të dhënave GERMIN është duke zbatuar që nga viti 2019 programin EDP në Kosovë dhe Shqipëri. Programi synon të sjellë profesionistë për një periudhë kohore duke filluar nga 3 javë deri në 6 muaj me idenë për t'u bashkuar me institucionet, organizatat dhe bizneset për të mbuluar nevojat e tyre profesionale. Së fundi, GERMIN ka krijuar bashkëpunime të ndryshme në kuadër të këtij projekti në mënyrë që të ndihmoj OShC-të në fushat deficitare apo në fusha tjera ku ato e shohin të nevojshme të angazhojnë ekspertë. Këto profile gjithmonë do të analizohen në aspektin e mungesës së tyre në Kosovë, prandaj bazuar në të, GERMIN shfrytëzon informacionet dhe bazën e të dhënave në mënyrë që të angazhoj në vendlindje profesionistët shqiptarë nga Kosova që jetojnë në vendet e zhvilluara.²

Profesionistët nga diaspora dhe GERMIN

Misioni i organizatës GERMIN është që përmes platformave të ndryshme që ka, të krijoj mundësinë e angazhimit vullnetar të profesionistëve nga diaspora në vendin e tyre amë e po ashtu të krijoj këtë urë lidhëse mes diasporës dhe vendit amë.

Përmes organizimeve të ndryshme në diasporë, GERMIN krijon kontaktet e po ashtu njofton audiencën në lidhje me projektet aktuale, përmes të cilës kërkohet angazhimi i profesionistëve. Së fundi, GERMIN ka organizuar një takim me profesionistë nga diaspora, në kuadër të projektit “Angazhim Qytetar” që zbatohet me mbështetjen e KCSF dhe USAID. Organizimi ishte në

¹ Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora, GERMIN, <https://telegrafi.com/mbahet-punetoria-e-pare-angazhimi-profesionisteve-nga-disapora-program-ky-qe-te-angazhoje-20-eksperte-nga-diaspora/>

² Programi “Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora, GERMIN/EDP, <https://germinprofessionals.germin.org/sq/about/>

Cyrih të Zvicrës, vend ku numri i shqiptarëve nga Kosova është shumë i madh dhe ku shumë prej tyre kanë mundësi me ndiku në politikbërje dhe planifikim ekonomik. Duke e parë potencialin që kanë shqiptarët nga Zvicra, GERMIN informoj mbi mundësitë e angazhimit të tyre në organizatat e shoqërisë civile, duke u bazuar gjithmonë në nevojat që OJQ-të kanë.³

Raporti i vitit 2020 nga GERMIN thekson që mbi 76% e diasporës janë të gatshëm të angazhohen në vendin e tyre amë vullnetarisht për të ndihmuar institucionet/organizatat në përmbushjen e nevojave të tyre.⁴ Kjo gatishmëri thekson edhe njëherë potencialin e madh që ka vendi, ku shumica e të anketuarve pohuan se ata do të ishin në gjendje të angazhoheshin fizikisht duke vizituar vendin amë ose virtualisht përmes platformave në internet. Ky konstatim i studimit është domethënës pasi tregon një interes të menjëhershëm për angazhim në çfarëdo forme për kontribut dhe ndikim pozitiv në vendin e origjinës.

Qëllimi

Duke e marrë parasysh rëndësinë që ekspertiza nga diaspora mund të sjellë në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës, është parë e nevojshme të krijohet një program i cili mundëson angazhimin e profesionistëve nga diaspora në vendin amë të tyre. Kjo tanimë po mundwsohet nga bashkëpunimi i KCSF dhe GERMIN nw partneritet me USAID pwrmes programit CEA, që të angazhoj profesionistët e diasporës në fushat ku në Kosovë ka mungesë të ekspertizës dhe njohurive do të ndihmonte OShC-të të zhvillojnë kapacitete të reja dhe të specializohen në fushat e punës së tyre, kështu duke mundësuar adresim më të mirë të problemeve dhe nevojave të qytetarëve. Duke shfrytëzuar rrjetin e vet të profesionistëve të diasporës, GERMIN do të angazhojë potencialin e diasporës për përfitim publik në Kosovë. Ky angazhim jo vetëm që ndihmon OShC-të në Kosovë, por gjithashtu krijon mundësi për bashkëpunim ndërmjet ekspertëve të diasporës dhe qytetarëve dhe ekspertëve në Kosovë, kështu duke kontribuar edhe në zhvillimin e vendit, në përgjithësi. Tutje, në mënyrë që të përmbushim nevojat në lidhje me

³ Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora, <https://www.albinfo.ch/germin-shpalos-ne-cyrih-programin-per-angazhimin-e-profesionisteve-nga-diaspora/>.

⁴ GERMIN, <https://germin.org/wp-content/uploads/2022/09/S HQIP-FINAL-Germin-Raport-1.pdf> , page 23.

ekspertizën, është e nevojshme që fillimisht të bëhet analiza e nevojave, e në këtë rast ato të organizatave të shoqërisë civile. Prandaj, qëllimi i këtij hulumtimi/hartëzimi të nevojave të OShC-ve, është të shohim më në detaje mungesën e profileve që OShC-të kanë, në mënyrë që të krijohet bashkëpunimi me diasporën përmes programit “Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora”, objektivi i të cilit është të ndihmojë OShC-të në Kosovë me ekspertiza nga diaspora në fushat të cilat ato e shohin të nevojshme. Pra, duke ditur nevojat e tyre, do të krijohej një pasqyrë më e qartë lidhur me profilet e nevojshme si dhe sfidat që OSHC-të kalojnë lidhur me qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e tyre drejt realizimit të qëllimeve që ato kanë.

METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij hulumtimi është metodologji e përzierë e cila përfshin të dhëna sasiore dhe cilësore. Përveq këtyre po ashtu përmban edhe disa aspekte krahasuese dhe analitike, lidhur me ojq në Kosovë, pra aktivitetet e tyre, dhe fushëveprimtaritë e tyre. Përmes këtyre të dhënave është më e lehtë dhe e drejtë të nxirren të dhëna për me pa më nga afër nevojat e ojq-ve për ekspertizë nga diaspora, si dhe po ashtu vet gjendjen e tyre aktuale sa i përket nevojave të tyre.

Mbledhja e të dhënave

Anketa

Përpos hulumtimit të literaturës kryesisht i bazuar nga hulumtimet e organizatave të ndryshme të përmendura më gjatë gjithë këtij hulumtimi, ku janë grumbulluar të dhëna lidhur me OShC-të (numrin e regjistruar), të dhënat e tjera janë grumbulluar përmes anketimit/pyetësorit online me 41 respondent kryesisht të plotësuar nga drejtorët ekzekutiv dhe menaxherët e programeve, si dhe përmes intervistave me drejtuesit e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Me anë të pyetësorit online janë grumbulluar të dhënat në lidhje me, ndër të tjera, hapësirat e punës, qeverisjen e brendshme të organizatave, kapaciteteve për aplikim për fonde, burimet e financimit, zbatimin dhe sfidat në zbatim të projekteve në kuadër të programeve të tyre, mungesën e profileve të shkaktuara nga migrimi i kohëve të fundit. Pyetësi ka qenë i

shpërndarë online në rrjetet sociale dhe website të GERMIN, KCSF dhe Civikos. Këtij pyetësori iu janë nënshtruar në mënyrë rastësore 41 organizata të shoqërisë civile.

Intervistat

Në mënyrë që të ketë sa më shumë detaje kualitative dhe thellim në aspektin e marrjes së informatave, ky raport/hartëzim përfshinë 7 intervista me udhëheqës të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë me fushëveprimtari të ndryshme. Në intervista janë marrë të dhënat në lidhje me profilet që iu mungojnë, misionit dhe strategjisë së tyre, shumëllojshmërisë së sfidave si dhe nevojave që ato kanë. Organizatat që u intervistuan ishin, Teach For Kosova, QHPSM, Instituti Paragon, Instituti 3S, Forumi për Aktivizim të Rinjëve, Vizioni i Drejtë, Rinia e Shalës. Para intervistës secili i intervistuar është njoftuar që të dhënat e marrura do të përdoren vetëm për shtjellim të raportit dhe analizim të nevojave për ekspertizë.

Përpunimi dhe analizimi i të dhënave

Mbledhja e informacioneve përmes internetit është një metodë efikase dhe shumë e përshtatshme për të arritur interesin e organizatave të shoqërisë civile. Tani që jemi në një trend të madh të shfrytëzimit të platformave të ndryshme sociale, të anketuarit në mënyrë virtuale ka lehtësuar shumë qasjen si dhe procesin e mbledhjes së të dhënave. Sidoqoftë, sfida në këtë proces është cilësia e përgjigjeve të dhëna nga responentet, mirëpo për të ndaluar mundësinë e ndikimeve të vlefshmërisë së gjetjeve në këtë raport/hartëzim të nevojave të organizatave për ekspertizë nga diaspora, është bërë edhe kontrolli i cilësisë së përgjigjeve duke u bërë përpunimi i të dhënave dhe për t'u siguruar që nuk ka probleme me pyetësin.

Analizimi dhe përpunimi i të dhënave është bërë direkt nga platforma surveymonkey, që e mundëson realizimin dhe paraqitjen e grafikave sipas të dhënave të dalura nga pyetësori, të rregulluara vizualisht si dhe të analizuara.

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË

Sipas hulumtimit të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), struktura e shoqërisë civile në Kosovë vazhdon të mbetet e ngjashme me ato të viteve të kaluara sa i përket misioneve dhe fushëveprimtarive të tyre, me përjashtim të rritjes së vazhdueshme të numrit të organizatave jo-qeveritare (OJQ) të regjistruara. Të ngjashme mbesin prezente mungesa e të dhënave sistematike dhe të besueshme për numrin e OJQ-ve që ushtrojnë aktivitet në Kosovë, si dhe natyrën dhe organizimin e tyre.⁵

Kështu, për sa i përket numrit të regjistruar të organizatave të shoqërisë civile, numri i saktë i tyre që ushtrojnë aktivitet brenda vendit është i vështirë të llogaritet. Shkaku kryesor është që departamenti për OJQ-të nuk ka mekanizma për komunikim të rregullt me të gjitha OJQ-të që janë të themeluara. Bazuar në regjistrin publik të OJQ-ve në Kosovë, të regjistruara janë gjithsej 9,545 OJQ, prej të cilave, 9,015 janë OJQ vendore, dhe 530 OJQ të huaja ose ndërkombëtare. Përkundër që Regjistri Publik i OJQ-ve numëron më shumë se 9,500 OJQ të regjistruara, ky numër nuk tregon gjendjen reale të sektorit apo numrin e organizatave aktive. Ka shumë organizata të cilat nuk ushtrojnë aktivitetet e tyre, e megjithatë llogariten aktive. Të dhënat e

⁵ Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile,

<https://www.kcsfoundation.org/ep-content/uploads/2018/12/Indeksi-Kosovar-i-Shoq%C3%ABris%C3%AB-Civile-2018.pdf>

departamentit përkatës mbesin të parifreskuara.⁶ Ndërsa, sa i përket shtrirjes gjeografike të OJQ-ve, ajo ndryshon sipas zonave. Shumica prej tyre janë të përqëndruara në zonat urbane të Kosovës (69.55%); Prishtina është qyteti me më së shumti OJQ të regjistruara (36.8%), e ndjekur nga Prizreni (7.7%), Mitrovica (7.2%), Peja (5.79%), Gjilani (4.6%), dhe Gjakova (4.55%).⁷


Nevojat e organizatave janë të ndryshme qoftë sa i përket profileve për ekspertiza e po ashtu edhe mbështetjeve të tjera. Gjatë intervistës me z. Arian Musliu, drejtor ekzekutiv i QHPSM, theksoi që “Nevojat e organizatave janë kryesisht në aspektin e menaxhimeve të denja, e po ashtu edhe vetë ndërtimin apo rritjen e kapaciteteve të brendshme, për ta bërë këtë kërkon shumë mund, energji, dhe financa”. Sipas z. Musliu është shumë e nevojshme që të kemi angazhime vullnetare të profesionistëve qoftë nga diaspora apo edhe ata brenda vendit. Sipas tij, “Angazhimi i profesionistëve është shumë i rëndësishëm, jo vetëm nga diaspora mirëpo edhe të tjerët që jetojnë e veprojnë në Kosovë dhe Shqipëri, të cilët veçse kanë arritë përfeksionimin e fushave të tyre”.

Në kuadër të hulumtimit të zhvilluar mbi nevojat e organizatave të shoqërisë civile, lidhur me fushëveprimtaritë e organizatave është parë një diversitet i veprimtarive. Në figurën e mëposhtme janë të detajuara fushat e veprimit të tyre (shih figurën 1.).

Figura 1:

⁶Po aty, faqe 21

⁷ Po aty, faqe 14.




Është më se e qartë që në Kosovë ekzistojnë shumë organizata, e shumica pre tyre janë kryesisht në Prishtinë. Po ashtu ka shumë OJQ të themeluara së fundi të cilat nuk zhvillojnë asnjë aktivitet, dhe është shumë e vështirë të kontrollohen, kjo si mungesë e mekanizmave të institucioneve relevante. Ndërsa vështirësia për disa organizata që operojnë një kohë të gjatë është financimi apo stabiliteti i tyre financiar. Bazuar nga hulumtimi është vërejtur që organizatat që janë më të vjetra në aspekt themelimi, kanë qenë në interes për programin e angazhimit qytetar, në mënyrë që të përfitojnë mundësinë e angazhimit të ekspertëve nga diaspora. Andaj nga 41 organizata që janë përgjigjur në këtë pyetësor, 56% janë të themeluara nga periudha 1999 deri 2010, 34% janë nga periudha 2010-2020, dhe 10% janë të themeluara në dy vitet e fundit, respektivisht, në periudhën ndërmjet viteve 2020-2022.

Bazuar nga organizatat respondente lidhur me madhësinë e tyre në aspekt të të punësuarve, grafika e mëposhtme (shih figurën 2.) tregon që 60% e të anketuarëve nga OSHC-të kanë 1 deri


në 5 persona si staf të punësuar, 22% kanë 5-10 persona, 12% kanë 10-15 persona, ndërsa vetëm 6% kanë mbi 15 persona si staf të punësuar në organizatën e tyre. Në bazë të kësaj tregohet që shumica e organizatave kanë një numër të vogël të stafit, dhe që ata varen kryesisht nga projektet nga donatorët e ndryshëm e me fonde më të limituara.

Figura 2:



Sa i përket aspektit të sfidave të qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile, mungesa e fondeve është më e theksuara, gjë që ndikon në performancën e organizatave në aspekt të iniciativave që marrin përsipër. Po ashtu të gjeturat e këtij hulumtimi tregojnë që organizatat kanë mungesë të strategjive për ngritjen e fondeve. Në diagramin më poshtë janë të shfaqura sfidat që ndikojnë në qëndrueshmërinë e organizatave. (Shih figurën 3.)

Figura 3:



Ndërsa sa i përketë pyetjes se “Cilat janë sfidat që hasni në implementimin e projekteve”?

Shumica e organizatave që janë përgjigjur që kanë vështirësi financiare, 34% e tyre janë shprehur që kanë mungesë të profileve adekuate, ndërsa 29% kanë shprehur që si sfidë e kanë pamundësinë për pagesë kompetitive në tregun e OSHC-ve si dhe pjesa tjetër kryesisht mbi 27% mbi vështirësitë financiare si dhe 10% kanë shprehur sfida të tjera që kryesisht lidhjen me mungesën e strategjive të brendshme.

NEVOJAT E ORGANIZATAVE PËR PROFESIONISTË NGA DIASPORA

Mungesa e profileve të ekspertizave në Kosovë ka filluar të ndjehet sidomos në valët e fundit të largimeve nga vendi, me theks të veçantë, mjekëve, inxhinierëve të fushës së IT-së dhe elektricitetit. Mirëpo shqetësues janë edhe profilet që janë kryesisht në shoqëri civile, qofshin ato në aspekt të vlerësuesve, monitoruesve si dhe projekt shkruesve.⁸ Gjatë intervistës, drejtori ekzekutiv i organizatës Teach For Kosova z. Egzon Gashi, theksoi që organizata që ai e drejton po hasë në shumë vështirësi tek profilet menaxheriale e po ashtu edhe ato të mësimdhënies. Ai thekson: “Ne si organizatë e kemi pa shumë të nevojshme që të sjellim në ekip profesionistë me eksperiencë në fushën e menaxhimit të projekteve e po ashtu edhe shkrimit të tyre, që të kontribuoj në rritjen e organizatës me projekte e po ashtu edhe tek trajnimi i brendshëm i stafit të ri. Përveç kësaj, duke u bazuar në misionin që kemi si organizatë e kemi vënë re që edhe mësimdhënësit janë profile që mungojnë sidomos tek shkollat që janë në fshatra”.⁹

Nevojën për ekspertizë e kanë parë edhe organizatat e tjera, drejtoresha e Institutit 3S, znj. Ardiana Veseli, për shembull, potencoi se “Fusha e sigurisë dhe shëndetësisë në Kosovë në aspektin e profesionistëve është shumë e mangët dhe se profesionistët e këtyre fushave janë duke lëshuar vendin për mundësi tjera në shtetet perëndimore. Nevojat e organizatës që drejtojnë janë kryesisht në fushat e sigurisë, shëndetësisë, profile këto që po është shumë e vështirë t'i angazhoj, jo vetëm që janë mungesë mirëpo edhe aspekti financiar është shpeshherë i pa përballueshëm.”¹⁰


⁸ Migrimi i Profesionistëve Jashtë Vendi - Vlerësim i Shkurtër Sociologjik, Behar Osmani, <https://filozofiku.uni-pr.edu/desk/inc/media/4ECD0B2E-05F1-4DC0-BAB8-605BDC8AFEAD.pdf>

⁹ Intervista, Egzon Gashi, Ne si organizatë e kemi pa shumë të nevojshme që të sjellim në ekip profesionistë me eksperiencë në fushën e menaxhimit të projekteve e po ashtu edhe shkrimit të tyre, që të kontribuoj në rritjen e organizatës me projekte e po ashtu edhe tek trajnimi i brendshëm i stafit të ri. Përveç kësaj, duke u bazuar në misionin që kemi si organizatë e kemi vënë re që edhe mësimdhënësit janë profile që mungojnë sidomos tek shkollat që janë në fshatra.

¹⁰ Intervista, Ardiana Veseli, Fusha e sigurisë dhe shëndetësisë në Kosovë në aspektin e profesionistëve është shumë e mangët dhe se profesionistët e këtyre fushave janë duke lëshuar vendin për mundësi tjera në shtetet perëndimore. Nevojat e organizatës që drejtojnë janë kryesisht në fushat e sigurisë, shëndetësisë, profile këto që po është shumë e vështirë t'i angazhoj, jo vetëm që janë mungesë mirëpo edhe aspekti financiar është shpeshherë i pa përballueshëm


Bazuar në punëtorinë e mbajtur në prill të vitit 2022, ku GERMIN njoftoj organizatat prezente lidhur me mundësinë e angazhimit të profesionistëve gjatë takimit organizatat paten mundësinë të shprehen nevojën që të angazhojnë ekspertë nga diaspora për t'i ndihmuar ato në fushat se ku e shohin të nevojshme si dhe aty ku ka mungesë në tregun e Kosovës. Në anketimin e zhvilluar organizatat kishin mundësi që të tregojnë lidhur me nevojën për ekspertizë, e ku numër i madh i tyre shprehen se kanë nevojë për ekspertizë, ndërkaq vetëm një numër shumë i vogël u shprehën se nuk kanë nevojë. Më poshtë figurativisht janë paraqitur përgjigjet e tyre. (Shih figurën 4.)

Figura 4:



Organizatat në Kosovë janë shprehur se janë shumë fusha ku ekspertiza është më se e nevojshme dhe që duhet të ndryshojë mënyra e aplikimit nga këto ekzistuese. Në kuadër të kësaj nevoje, nga 41 organizata pjesëmarrëse në hulumtim, 33 nga to kanë shprehur sektorët apo profilet e nevojshme. Në mënyrë grafike më poshtë janë të paraqitura profilet. (Shih figurën 5).

Figura 5:



Gatishmëria dhe profilet e kërkuara nga organizatat për ekspertë nga diaspora u paraqiten si të shumëllojshme në aspekt të nevojës. Aspekti kohor i angazhimit është një pjesë tjetër e rëndësishme të cilën organizatat e theksuan përmes nevojës së tyre për ekspertë. Në pyetjen rreth aspektit kohor të angazhimit, periudha ndërmjet 1 dhe 3 muaj angazhim është konsideruar si më e arsyeshme, ku 90% të respondentëve e konfirmuan këtë, shih figurën e mëposhtme (fig. 6):

Figura 6:




Bashkëpunimi i organizatave me ekspertët, bazuar nga hulumtimi, mendohet se do ta rriste performancën e tyre, sipas metodave të cekura më poshtë:

- 75% - Mundësi bashkëpunimi për praktika/metoda, apo perspektivë të re për organizatën;
- 14% - Ofrimin e trajnimeve sipas nevojave që kanë organizatat në kuadër të zhvillimit të stafit;
- 11% - Të tjera (që lidhen me mundësitë për trajnime për turizëm, siguri, etj).

Nga rezultatet e kësaj përgjigje shihet qartë që organizatat e shoqërisë civile interesin më të madh e kanë për të përfitur metoda dhe perspektiva të reja për organizatën.

Në anën tjetër, në pyetjen se a kanë pasur përvojë të mëparshme me ekspertë nga diaspora, shumica dërrmuese e përgjigjeve ishin që nuk kanë pasur ndonjë përvojë të mëparshme. Ky fakt tregon që projekti për angazhim të profesionistëve nga diaspora është shumë i qëlluar dhe i nevojshëm. Kjo jo vetëm për ndihmën ndaj organizatave, mirëpo edhe në lidhjen e diasporës me vendin amë.

Figura 7:




Grafiku i mësipërm (fig. 7) tregon se vetëm 24% e të anketuarëve nga OSHC-të janë shprehur që kanë patur përvojë të mëparshme me ekspertë nga diaspora, ndërsa 76% prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë patur ndonjë përvojë të mëparshme me ekspertë nga diaspora. Tek kjo pjesë e hulumtimit, organizatat të cilët kishin përvojë të mëparshme me angazhimin e profesionistëve, theksuan 4 fusha në të cilat profesionistët kontribuan më së shumti, të cilat janë të lidhura kryesisht me Monitorim dhe Hulumentim dhe Ngritjen e Kapaciteteve, rrjedhimisht profile të specializuara në këto dy fusha kanë qenë më të kërkuara nga shumë organizata bazuar në hulumtimin e bërë. Nga 41 respondentë, në këtë pyetje janë përgjigjur 4 organizata të cilat kanë pasur persona të angazhuar nga diaspora në fushat e mëposhtme:

- 75% - Monitorim dhe Hulumentim;
- 15% - Ngritja e Kapaciteteve të stafit.


Arritja e rezultateve të caktuara gjatë angazhimit është parë si më e arsyeshme në krahasim me rëndësinë e kohës dhe gjatësisë së angazhimit të profesionistëve. Në mendimin se a dëshirojnë që angazhimin ta kenë në bazë të rezultateve të caktuara e jo të kohës, shumica e respondentëve ishin direkt për angazhim për një rezultat të caktuar, mirëpo organizatat potencuan që kjo varet po ashtu shumë nga projekti, e që lejon mundësi pune në distancë. Nga 41 respondentë, 30 prej tyre potencuan të dhënat si më poshtë (shih figurën 8):

Figura 8:




Pa marr parasysh kohën e angazhimit, qëllimi kryesor është arritja e rezultateve të pritura. Se a mendojnë që angazhimin e ekspertëve ta kenë në mënyrë virtuale (shih figurën 9) apo në distancë, kjo nuk shfaq ndonjë problem apo pamundësi. Si e rëndësishme u theksua të jetë arritja e qëllimeve në bashkëpunim me ekspertin/en. Shumica dërrmuese nuk e panë si problem angazhimin virtual.

Figura: 9



Gatishmërinë që përveç mundësisë së angazhimit në mënyrë virtuale, organizatat po ashtu janë shprehur të gatshme që të organizojnë edhe angazhimin me prezencë fizike për profesionistë nga diaspora. Organizatat janë deklaruar se janë në gjendje që të sigurojnë kushte adekuate brenda hapësirës që ata disponojnë. Në kuadër të këtyre kushteve shihen si më të rëndësishme ofrimi i vendit për të implementuar strategjitë apo planet e ekspertëve, si dhe vënja në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për zbatim të ideve. Në grafikën e mëposhtme (fig. 10) shihet gatishmëria e ofrimit të kushteve për të angazhuar ekspertë nga diaspora.

Figura 10:



KONKLUZION

Potenciali i madh dhe i pa shfrytëzuar i diasporës shqiptare është shumë i dukshëm nëse bazohemi në hulumtimet paraprake që GERMIN ka realizuar.¹¹ Është evidente që diaspora ka krijuar një vend shumë të rëndësishëm në shtetet se ku është e shtrirë, dhe se integrimi i tyre në shoqëri është për t'u marr shembull. Në kuadër të këtij hulumtimi është parë nevoja e madhe që organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kanë për ekspertiza të ndryshme, e kjo lidhet menjëherë edhe me migrimin e madh që po ndodh të profileve shumë të përgatitura drejt vendeve perëndimore, gjë që po ndikon në cilësinë dhe zhvillimin e institucioneve dhe organizatave në Kosovë.

Bazuar në të gjeturat e hulumtimit, u dëshmuua që shumë profile janë të nevojshme që të ndihmojnë organizatat në mbajtjen në ekzistencë të tyre dhe në fuqizimin e qendrueshmërisë së tyre. Duke e pasur parasysh që së fundi shoqëria civile në Kosovë në fokus ka vendosur rritjen e fondeve edhe përmes burimeve të tjera, kjo u theksua edhe tek pyetësoni dhe tregon që vetëdijësimi dhe kërkesat e organizatave janë të theksuara në kërkim të profileve që mund të ndikojnë në rritjen e stabilitetit të tyre financiar. Përveç kësaj, mungesa e fondeve për të angazhuar ekspertë për mbulimin e nevojave të tyre ishte shqetësimi tjetër kryesor i potencuar jo vetëm përmes pyetësonit, mirëpo edhe përmes intervistave të bëra me organizatat me fushëveprimtari, madhësi, dhe rëndësi të ndryshme.

Pjesa tjetër e rëndësishme është edhe vetëgatishmëria e organizatave për të angazhuar ekspertë bazuar në nevojat që kanë, e kjo duke siguruar kështu edhe vendin ku mundet eksperti/ja të zbatoj planin apo të ushtroj profesionin në kuadër të angazhimit. Përmes kësaj është shumë e rëndësishme të shihet serioziteti dhe dëshira e organizatave të bashkëpunojnë me ekspertë nga diaspora e kështu të zhvillojnë sektorët apo nënsektorët sipas nevojës që kanë. Përmes këtij hulumtimi është arritur të shfaqet nevoja e organizatave të shoqërisë civile për ekspertë nga diaspora, kjo duke përmendur shumë fusha në të cilat mendojnë se e kanë nevojën e po ashtu duke ofruar edhe ato gatishmërinë dhe dedikimin për të mësuar e trajnuar stafin e tyre.

¹¹ GERMIN, <https://germin.org/wp-content/uploads/2022/09/SHQIP-FINAL-Germin-Raport-1.pdf>

Hartëzimi i nevojave dhe mënyrës së angazhimit të profesionistëve është i dukshëm, si dhe dëshira dhe vullneti për të bashkëpunuar është i theksuar andaj ky hulumtim shërben si një bazë e parë e fokusit apo targetit për të filluar kontaktimin dhe lidhjen me ekspertë të diasporës.

Rekomandimet:

1. Kohëzgjatja e angazhimit të profesionistëve nga diaspora të jetë 1-3 muaj;
2. Shpalljet e ardhshme nga ojqtë të specifikohen në rritjen e fondeve, menaxhimin e projekteve, monitorimin e mbarvajtjes së projekteve, dhe rrjetizimi me diasporën, për krijimin e mundësive në rritje fondesh dhe bashkëpunime me donator potencial nga fushat biznesore;
3. Angazhimi të fokusohet kryesisht në prezencë fizike, si dhe në objektivat dhe qëllimet e përcaktuara.

REFERENCAT

1. Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora, GERMIN,
<https://telegrafi.com/mbahet-punetoria-e-pare-angazhimi-profesionisteve-nga-disapora-program-ky-qe-te-angazhoje-20-eksperte-nga-diaspora/>
2. Programi “Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora, GERMIN/EDP,
<https://germinprofessionals.germin.org/sq/about/>
3. Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile,
<https://www.kcsfoundation.org/ep-content/uploads/2018/12/Indeksi-Kosovar-i-Shoq%C3%ABris%C3%AB-Civile-2018.pdf>
4. Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora - vizita ne Cyrih,
<https://www.albinfo.ch/germin-shpalos-ne-cyrih-programin-per-angazhimin-e-profesionisteve-nga-diaspora/>.
5. Migrimi i Profesionistëve Jashtë Vendit - Vlerësim i Shkurtër Sociologjik, Behar Osmani,
<https://filozofiku.uni-pr.edu/desk/inc/media/4ECD0B2E-05F1-4DC0-BAB8-605BDC8AFEAD.pdf>

Intervistat:

- **Egzon Gashi - Drejtor Ekzekutiv - Teach For Kosova**
- **Arian Musliu - Drejtor Ekzekutiv - QHPSM**
- **Ardiana Veseli - Drejtoreshë Ekzekutive - Instituti 3S**
- **Florian Aliu - Menaxher i Programeve - Instituti Paragon**
- **Erzen Hyseni - Menaxher i Programeve - Forumi per Aktivizimin e te Rinjve**
- **Fatlind Gashi - Menaxher Projekti - Vizioni i Drejtë**
- **Leutrim Pajaziti - Drejtor Ekzekutiv - Forumi Rinor i Shalës.**

PYTESORI

<https://www.surveymonkey.com/r/TQ9C5W2>